

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, Znj. Delina Ibrahimaj

Përshëndetje,

Sot kam kënaqësinë të marr pjesë në Panairin e Punës 2017, organizuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit me pjesëmarrjen e INSTAT, për ti shtuar bashkëpunimit të këtyre dy institucioneve edhe një mjet tjetër të rëndësishëm; një Memorandum Bashkëpunimi.

Ndër vite, INSTAT dhe SHKP kanë shkëmbyer të dhëna të vlefshme mbi punësimin dhe papunësinë, që kanë ndihmuar palët në prodhimin e statistikave të tregut të punës dhe në hartimin e politikave për nxitjen e punësimit dhe reduktimin e papunësisë në vend.

Informacioni i prodhuar dhe i shkëmbyer është zgjeruar dhe përmirësuar në funksion të vetëdijes se politikat eficiente janë të orientuara nga statistikat.

Në vijim të eksperiencës së ndërtuar ndër vite, INSTAT dhe SHKP do të vazhdojnë bashkëpunimin e mirë, me qëllim që të përmirësojnë cilësinë e prodhimit statistikor në përputhje me parimet e statistikave zyrtare, me qëllim që t'i përgjigjen në kohë dhe me cilësi kërkesave gjithnjë në rritje të përdoruesve.

Memorandumi i Mirëkuptimit synon të rrisë performancën e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, duke rregulluar mënyrën e organizimit të punës dhe transmetimit të të dhënave.

INSTAT, si prodhuesi kryesor i statistikave në vend si dhe për të përmbushur rolin e tij si Koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor punon që të rrisë ndikimin e kulturës së statistikave duke ofruar metodologji, trajnime, ngritje kapacitetesh dhe kontroll cilësie për agjencitë e tjera statistikore dhe institucionet mbledhëse dhe përdoruese të të dhënave.

Pikërisht, për të përmbushur këtë rol në udhëheqjen e statistikave të prodhuara, INSTAT ka ndërmarrë një proces hartimi memorandumesh bashkëpunimi me 18 ministri apo institucione të varësisë, me qëllim për të zgjeruar nivelin e bashkëpunimit e për të rritur standardizimin dhe harmonizimin me statistikat europiane.

Duke ju falenderuar për vëmendjen, ju ftoj tani në firmosjen e memorandumit.

Instituti i Statistikave merr pjesë në Panairin e Punës 2017, i cili zhvillohet në ambientet e Pallatit të Kongreseve në datat 29-31 Mars 2017.